

Ministria për Fëmijët, Familjen, Refugjatët dhe Integrimin e Landit Nordrhein-Westfalen



26.03.2021

Informacione për prindërit

fëmijët e të cilëve ndodhen nën kujdestarinë e qendrave të kujdesit ditor për fëmijë ose nën përkujdesje ditore për fëmijë

Informacione për bartësit, strukturat drejtuese, personelin

e qendrave të kujdesit ditor për fëmijë ose qendrave për përkujdesje ditore për fëmijë

Përkujdesi ditor i fëmijëve pas ditëve të Pashkëve

Përkujdesi ditor i fëmijëve në Nordrhein-Westfalen do të vazhdojë të qëndrojë në veprim të rregullt të kufizuar edhe pas ditëve të Pashkëve, fillimisht të paktën deri më 11 prill 2021.

Vijojnë të mbeten të vlefshme udhëzimet e Rregullores në Përkujdesje ndaj Koronës, çka do të thotë, që ndërmjet të rriturve duhet të mbahet distanca minimale prej 1,5 metrash. Nëse distanca minimale nuk mund të respektohet dot, çdo i rritur duhet të mbajë një maskë mjekësore. Duhet të merren masat e duhura higjienike dhe të sigurohet gjurmueshmëria.

Për qendrat e kujdesit ditor të fëmijëve vlen sa vijon:

- Në mbarë Landin do të zbatohet ndarja në grupe, që do të thotë, përcaktimi i mjediseve fikse, me përbërje fikse (gjithmonë të njëjtët fëmijë) dhe, si rregull një staf fiks.

- Në mënyrë që të bëhet e mundur ndarja në grupe, koha e kujdesit ditor në këto qendra do të kufizohet për secilin fëmijë në 10 orë në javë, në mbarë Landin. Për aq kohë që burimet përkatëse të personelit e lejojnë një gjë të tillë dhe për aq kohë që përjashtohet mbingarkesa e situatës së përgjithshme në institucion, do të jetë i mundur një kapacitet më i madh kujdesi ose mund të hiqet dorë nga kufizimi. Për modelin e përshtatshëm vendos vetë institucioni ose bartësi.

Në qendrën e përkujdesit ditor të fëmijëve vlen sa vijon:

- Në qendrën e përkujdesit ditor të fëmijëve zbatohet trajtimi i përkujdesit të fëmijëve brënda kornizave kohore të kontratave për përkujdesin. Në qendrën e madhe të përkujdesit ditor duhet që brënda mundësive, të respektohet ndarja fizike e personelit të qendrës së përkujdesit ditor të fëmijëve me fëmijët që u janë caktuar atyre për gjatë gjithë kohës së përkujdesit ditor.

Procedimi në rastin e simptomave të sëmundjes:

Qëndron parimi: Fëmijët e sëmurë nuk bëjnë pjesë në qendrën e kujdesit ditor për fëmijë, ose në qendrën e përkujdesit ditor për fëmijë! Fëmijët me temperaturë dhe/ose me simptoma të tilla, që sipas mendimit të prindërve ose të institucionit apo qendrës së përkujdesit ditor, flasin për një sëmundje akute, infektive ose ngjitëse, nuk duhet të mbahen në përkujdesje. Në këtë pikë, prindërve u bëhet shprehimisht apeli, që në raste të tilla të mos i sjellin fëmijët e tyre për mbajtje nën kujdes, dhe kjo bëhet në mbrojtje të punonjësve, të personelit të kujdesit ditor të fëmijëve, si edhe të fëmijëve të tjerë. Përpara këtij sfondi, vijon të vlejë ajo, që institucioni ose personi kujdestar i përkujdesit ditor mund të refuzojë përkujdesin, për aq kohë, që një fëmijë, sipas mendimit të tyre, tregon simptoma të sëmundjes, të cilat e përjashtojnë kujdesin e përgjegjshëm. Në rastin e rufës, pa shenja të tjera të sëmundjes, duhet që fëmijët të vëzhgohen në shtëpi për 24 orë rresht. Nëse nuk paraqiten simptoma të tjera, fëmija do të qëndrojë sërish nën kujdes. Rekomandimet për mënyrën e procedimit në rastin e simptomave të sëmundjes tek fëmijët duhet të zbatohen më tej me konsekuencë.

**Ministria për Fëmijët, Familjen, Refugjatët dhe Integrimin
e Landit Nordrhein-Westfalen**